



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština - Assembly***

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 107

Prishtinë, më 25.04.2024, në orën 09:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

P R O C E S V E R B A L

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Hydajet Hyseni- Kaloshi, Hajdar Beqa, Erxhan Galushi dhe Besnik Tahiri.

**Munguan:** Blerta Deliu-Kodra.

**Mbledhjen e kryesoi** Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Vlora Selimi, RTV Dukagjini; Natyra Salihaj, Ekonomia Online; Valon Dobruna, Kuvend; Arbër Thaçi, KDI.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 12.3.2024;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje;

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 08/L-242 për performancën energetike të ndërtesave;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.08/L-207 për tekste shkollore;
8. Formimi i grupit punues për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative;
9. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 12.3.2024**

*Kryetari konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur më datë 12.3.2024, u miratua.*

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat**

**Kryetari**, tha se do ta prezantoj qëllimin e këtij ligji dhe ky ligj është sponsorizuar nga Zyra e Kryeministrit. Ai shtoi se nuk është ftuar ndonjë përfaqësues i qeverisë për ta prezantuar. Ky është një projektligj specifik, që synon të krijojë bazën ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat, në kuptimin e plotësimit të ligjeve të veçanta, ku mungon baza ligjore për aktet nënligjore, që do të duhej t'i nxirrte qoftë qeveria, qoftë ministratë. Kryetari potencoi se qeveria ka shfuqizuar një numër të konsiderueshëm të akteve nënligjore gjatë këtyre viteve në mungesë të bazës ligjore për to dhe është paraqitur nevoja që të krijohet baza ligjore në ligje të veçanta për këto akte nënligjore.

**Driton Selmanaj**, tha se këtë ligj nuk e kupton as nga emri, por as nga përmbajtja, sepse ky lloj emërtimi nuk është hasur në historinë e parlamentarizmit në Kosovë, dhe për këtë arsye, do të ishte në interes të dëgjohet një përfaqësues nga qeveria, që të tregojë se nga ka ardhur kjo ide, që të krijohet një projektligj i tillë. Në vijim, deputeti Selmanaj potencoi se praktika që me një ligj të vetëm të ndryshohen 38 ligje të aplikueshme në Kosovë, është shumë e dëmshme për procesin ligjvënës dhe tha se e kemi diskutuar edhe në seancë plenare për një model që quhet omnibus e që ka të bëjë me mundësinë që të ndryshohen shumë ligje, me një ligj të veçantë, por vetëm kur të preket materia e njëjtë në të gjitha ligjet. Deputeti Selmanaj theksoi se nëse lexohen me kujdes emrat e të gjitha ligjeve dhe nëse thuhet se kanë diçka të përbashkët, do të isha shumë i nderuar nëse më shpjegoni çfarë ka të përbashkët ligji për plehrat artificiale me ligjin për statusin dhe imunitetin e stafit diplomatik, çfarë ka të përbashkët ligji për materialin fidanor me ligjin për patentë shofer, çfarë ka të përbashkët ligji për shoqërinë e informacionit, me ligjin e të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, çfarë ka të përbashkët ligji për Forcën e Sigurisë, me ligjin për dokumentet e udhëtimit? Me aq sa kam arritur t'i analizoj me kujdes, kam arritur në përfundimin që ministratë kanë miratuar një numër të akteve nënligjore, që janë të kundërligjshme dhe kur e

kanë vërejtur që janë të kundërligjshme, ata kanë sjellë një akt të vetëm ligjor për t'i ndryshuar 38 ligje, që t'u jepet bazë ligjore udhëzimeve administrative që i kane miratuar tash e tre vite. Më pas, ai shtoi duke thënë se nëse lexohet memorandum i shpjegues, ku thotë se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga ana e ministrave, të njëjtat janë identifikuar si të pabazë të mirëfilltë ligjore gjatë hartimit të analizës juridike për vlerësimin e bazës ligjore të akteve nënligjore të nxjerra nga ministrat të miratuara, me vendime të qeverisë, më datë 23.12.2021.

Kjo lind dyshimin e menjëhershëm se veprimet e kundërligjshme të shumë ministrave dhe të qeverisë në përgjithësi, që duan t'i formalizojnë në këtë projektligj, nëse mendojmë që kjo duhet të vlejë për të ardhmen, atëherë duhet të ndryshojmë ligje të veçanta, tha ai.

Deputeti Selmanaj vazhdoi duke thënë se me këtë projektligj janë prekur disa ministri, si Ministria e Brendshme, me dhjetë ligje, Ministria e Bujqësisë, me shtatë ligje, Ministria e Ambientit, me pesë ligje, Ministria e Financave, me pesë ligje, Ministria e Jashtme, me tre ligje, Ministria e Ekonomisë, me tre ligje, Zyra e Kryeministrit, me tre ligje, Ministria e Shëndetësisë, me një ligj dhe, Ministria e FSK-së, me një ligj. Pra, po ndryshohen 38 ligje, për t'ua gjetur bazën ligjore udhëzimeve administrative, që i kanë miratuar ministrat e ministritë dhe qeveria.

Më pas, theksoi se Zyra e Kryeministrit është dashur ta dërgojë një përfaqësues të tyre për të na sqaruar këtë qasje shumë të pakuptimtë në këtë proces dhe shtoi se është kundër, dhe nëse procedohet, do të detyrohen që këtë projektligj ta dërgojnë në Gjykatë Kushtetuese, sepse është praktikë e dëmshme për parlamentarizmin në Kosovë.

**Kryetari**, tha se metodologjinë omnibus për ndryshimin e disa ligjeve përmes një ligji, e kemi diskutuar edhe më parë në Kuvendin e Kosovës dhe nuk është e ndaluar, por mund të pajtohemi që nuk është metoda më e mirë për plotësim-ndryshimin e ligjeve. Ndërsa, në anën tjetër, ky projektligj synon të krijojë bazën ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore për 38 ligje në fuqi, mirëpo bëhet fjalë për ndryshime me nga një nen, ku e përcakton bazën për nxjerrjen e akteve nënligjore, sqaroi deputeti Rrustemi.

Në lidhje me atë që u potencua me pretendimin për të përligjur aktet administrative, që tashmë janë nxjerrë dhe nuk kanë bazë ligjore, tha se kjo nuk qëndron, sepse me informacionet që ka, mbi një mijë akte nënligjore janë shfuqizuar nga qeveria, pikërisht për këtë arsye që iu mungon baza ligjore në ligje të veçanta.

Nëse shihet se çfarë kanë të përbashkët ligji për plehrat artificialë dhe shërbimin diplomatik, natyrisht që në kuptimin e përmbajtjes nuk kanë asgjë të përbashkët, por në kuptimin e bazës ligjore për të nxjerrë akte nënligjore, kjo është e përbashkëta, theksoi mes tjerash ai.

**Driton Selmanaj**, tha se në tri ministri, këto udhëzime administrative vetëm se ekzistojnë prej vitit 2002 dhe tani doni t'i shfuqizoni dhe të krijoni bazë tjetër ligjore, për të arsyetuar nxjerrjen e udhëzimeve administrative. Kjo nuk është në rregull dhe ky projektligj duhet t'i kthehet qeverisë, sepse edhe qytetarët e kanë vështirë ta kuptojnë, madje kam përshtypjen që edhe vetë ministrat dhe qeveria, që do të punojnë me këtë, nuk do të mund të gjejnë ndryshimet që i kanë bërë nëpër akte të caktuara ligjore, theksoi ai.

**Besnik Tahiri**, tha se kemi diskutuar herën e parë për metodologjinë e omnibusit, e cila trajton një seri të ligjeve në plotësim-ndryshim. Kjo praktikë ka qenë jo vetëm e kundërshtuar, por edhe me shumë pikëpyetje prej shumë juristëve, por edhe prej faktorit ndërkombëtar, që na ka ndihmuar

në ligj-bërje, me metodologjinë e omnibusit, e kam votuar reformimin e agjencive ekzekutive, sepse e kam parë të arsyeshme që një metodologji e tillë e ka një qëllim të caktuar strategjik në reformimin e administratës shtetërore, në zvogëlimin e agjencive dhe e kam parë si normale që ta shtyjme përpara, por problemin e shoh të përmbajtja dhe jo të metodologjia, sepse me një ligj të vetëm po u japim mundësi 38 institucioneve që rregullohen me ligje të veçanta, që me akte nënligjore, për ta prekur funksionimin e vet mbi bazën e vullnetit politik të një ministri, tha ai.

Deputeti Tahiri, në vijim, tha se duke e pasur këtë çështje, vijmë deri tek analiza e qëllimit dhe nëse i shohim ligjet një nga një, të gjitha prekin sektorë dhe të gjithë ata sektorë, si në arsim apo në bujqësi, ia vendosin të drejtën e padiskutueshme ministrit, për një rregullim të brendshëm që në esence është kundërligjor.

Mendoj që është e gabuar dhe e mirëkupton, kur ka një qëndrim politik, siç ishte te racionalizimi i agjencive ekzekutive, mirëpo kjo qasje është shumë e gabueshme dhe e dëmshme. Kjo praktikë e ndryshimit të 38 ligjeve, e transferimit të diskrecionit të ministri për të bërë me akt nënligjor diçka që e rregullon ligji, është dobësim dhe është devalvim i sistemit në administratën shtetërore, tha ai.

**Kryetari**, tha se ministrinë dhe qeveria e kanë për nga natyra dhe të domosdoshme nxjerrjen e akteve nënligjore në funksionimin e tyre të përditshëm dhe secili ligj ia njeh këtë të drejtë dhe këtë mundësi, prandaj në rastin konkret, këto 38 ligje, disa çështje specifike nuk i kanë përcaktuar dhe ne po e bëjmë këtë gjë, theksoi ai.

**Besnik Tahiri**, tha se nuk e kundërshton metodologjinë si metodologji për një qëllim më fisnik më të lartë, siç ka qenë zvogëlimi i agjencive ekzekutive dhe shtoi se konteston metodologjinë kur preken 38 ligje në një nen, ku ai nen i jep diskrecion një ministri, një ministrie që të bëjë çfarë të dëshirojë me një akt nënligjor për temën e caktuar.

**Hajdar Beqa**, tha se me ligjet që janë në fuqi, dikasteret përkatëse kanë të drejtën për të nxjerrë akte nënligjore, mirëpo konsideroj që është e domosdoshme që sponsorizuesi i këtij ligji të na shpjegojë çfarë ka dashur të thotë, sepse mendoj që do të kemi problem në implementim, sepse kur nxirren aktet nënligjore, është e pamundur të ketë harmonizim të bazës përmbajtjesore apo të metodologjisë, tha ai.

Në këtë fazë nuk e përkrahim dhe nuk dëshirojmë të lëshohemi në përmbajtjen e 38 ligjeve, që i rregullojnë në një formë apo në tjetrën të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, është jo-serioze të diskutojmë për një materie, për të cilën as ne nuk kemi informatë të mjaftueshme. Konsideroj se si të tillë nuk e përkrahim, duhet t'i kthehet qeverisë, tha ai.

**Dimal Basha**, tha se te metoda duhet të ketë debat dhe u fol këtu se a duhet te ndryshohen 38 ligje me një projektligj të vetëm, mirëpo te përmbajtja nuk ka problem. Secili ligj amendamentohet, nëse vijnë këto ligje një nga një, bëhet po i njëjti ndryshim dhe nuk ka asnjë kundërshtim. Pyetja është, a duhet ta bëjmë ndryshimin vetëm me një projektligj, apo të na vijnë 38 ligje, ku bëhet amendamenti? Bëhet votimi dhe nuk ndryshon asgjë, tha ai.

**Driton Selmanaj**, tha se po të vinte secili ligj, do të përcilleshin në komisionet përkatëse dhe do të trajtohej ndoshta me muaj të tërë një amendamentim, ku për një amendament të vetëm, shoqëritë e pjekura me muaj të tërë diskutojnë në forma të ndryshme, ndërsa ne po dëshirojmë t'i mbulojmë

të gjitha këto, pa treguar se çfarë po preket dhe çfarë kompetencash po iu barten ministrave me akt nënligjor, prandaj kjo mënyrë është gabim, theksoi mes tjerash ai.

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për, një kundër dhe një abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat.

#### **4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës**

**Kryetari**, tha se ky ligj përmban një nen dhe synon që të krijojë për bashkatdhetarët nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të kenë të drejtën pronësore, të jenë titullarë të pronës në territorin e Republikës së Kosovës. Pra, heqja e këtij kufizimi është shumë i rëndësishëm, tha ai.

**Dimal Basha**, tha se është një plotësim-ndryshim shumë i mirë për komunitetin shqiptar, që vjen nga Lugina e Preshevës, është një lajm i mirë që ata tash e tutje mund t'i bartin pronat e tyre në emrin e tyre, tha ai.

**Hajdar Beqa**, tha se si Parti Demokratike, e përkrahin projektligjin, sa i përket këtij ndryshimi.

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.08/L-290 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.08/L-013 për të drejtat pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

#### **5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje**

**Kryetari**, tha se përsëri kemi të bëjmë me metodën omnibus të plotësim-ndryshimit të ligjeve të veçanta, në kuptimin e harmonizimit me ligjin për kundërvajtje.

**Hajdar Beqa**, tha se kjo dallon esencialisht me ligjin paraprak dhe me ndryshimin, me votën e mazhorancës, ku për 38 ligje menduam që po e ndryshojmë vetëm metodologjinë, por po ndryshohet edhe përmbajtja. Ndërsa, sa i përket ligjit për kundërvajtje, deputeti Beqa tha se ka pasur praktika edhe në të kaluarën dhe ndoshta nuk është rruga më e mirë, por është më e mundshmjja për momentin.

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe një abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet në parim, Projektligji nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje.

#### **6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave**

**Kryetari**, tha se Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim, ka paraqitur 24 amendamente për Projektligjin nr. 08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave, dhe Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 të Rregullores së Kuvendit, vlerëson raportin dhe projektligjin se a është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni vendosi që me gjashtë vota për dhe një abstenim, Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.08/L-242 për performancën energjetike të ndërtesave dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.08/L-207 për tekste shkollore**

**Kryetari**, tha se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, ka paraqitur 11 amendamente dhe Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 i Rregullores së Kuvendit, vlerëson nëse projektligji, amendamentet dhe procedura, janë në rregull dhe se a janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme.

*Meqë nuk pati diskutime, kryetari konstatoi se Komisioni vendosi që me gjashtë vota për dhe një abstenim, Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr. 08/L-207 për tekste shkollore dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

## **8. Formimi i grupit të punues për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative**

**Kryetari**, tha se Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, është miratuar në lexim të parë në seancë dhe i përket Komisionit për Legjislacion, për të formuar grupin punues dhe për ta trajtuar nen për nen këtë ligj të rëndësishëm.

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se me shumicë votash, nxori këtë:*

### **Vendim**

Për formimin e grupit të punës për Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, në këtë përbërje:

1. Adnan Rrustemi, kryesues,
2. Erxhan Galushi, anëtar,
3. Dimal Basha, anëtar,
4. Hajdar Beqa, anëtar,
5. Besnik Tahiri, anëtar,
6. Driton Selmanaj, anëtar.

## **9. Të ndryshme**

**Kryetari**, tha se duhet ta procedoj për votim letrën e deputetit Visar Korenica, të cilën e kemi diskutuar, mirëpo duhet t'i kthejmë përgjigje për çështjen e numërimit të votave.

*Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni vendosi që me gjashtë vota për dhe një kundër, deputetit Visar Korenica, për çështjen e numërimit të votave, t'i kthehet përgjigja me përmbajtjen, si vijon:*

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në mbledhjen e mbajtur më 25.4.2024, e shqyrtoi shkresën e deputetit Visar Korenica, përmes të cilës kërkon verifikimin e votimit për dy projektligje, i cili pretendon se nuk ka pasur kurorum të mjaftueshëm.

Deputeti Korenica pretendon se nuk ka pasur kurorum të mjaftueshëm për votimin e Projektligjit nr.08/L-212 për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar mjekësor, **në lexim të dytë**, dhe Projektligjit nr.08/L-207 për tekste shkollore, **në lexim të parë**.

Komisioni për Legjislacion konstaton se kërkesa e deputetit për ta verifikuar kuroumin nuk bie në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion. Komisioni, po ashtu konstaton se nuk ka të bëjë me interpretim të Rregullores, sipas nenit 122, ku të drejtat e deputetit ndërliken me të drejtën për të

diskutuar dhe replikuar, e në rastin konkret, kërkesa e deputetit nuk ndërlidhet me diskutimet e tij, por konteston votimin në kuptimin e numërimit të votave. Numërimi i saktë apo jo, sikurse që verifikimi i numërimit nuk bie në fushëveprimin e Komisionit.

Para votimit, Kryetari Kuvendit konstaton nëse janë plotësuar kushtet për të hyrë në votim, ashtu siç konstaton dhe kumton numrin e votave PËR, KUNDËR dhe ABSTENIM. Në rastin konkret, Kryetari ka konstatuar miratimin e projektligjeve, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

*Duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Komisioni vlerëson se nuk është në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion, procesi i verifikimit të votimit të deputetëve në seancë plenare.*

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

---